



PËRTEJ KUFIVË **TË SHKOLLËS**

NJË PERSPEKTIVË
PËR NDËRTIMIN E
KOMUNITETEVE
TË QËNDRUESHME

Shënim:

Projekti “Përtej kufijve të shkollës drejt një komuniteti të qëndrueshëm” zbatohet nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) dhe mbështetet financiarisht nga Zyra për Marrëdhënien me Publikun e Ambasadës së SHBA-së në Tiranë. Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë material janë të autor-it/ve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.



U.S. EMBASSY
Tirana, Albania

Me mbështetjen financiare të Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun të Ambasadës së SH.B.A.-së në Tiranë



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

PËRSE
SHKOLLA.SI
**QENDËR
KOMUNITARE?**

a

është një **instrument** me bazë shkollën që ndërlidh institucionet në nivel vendor me komunitetin, shoqërinë civile për të forcuar kohezionin në përballje ndaj sfidave të sigurisë dhe ekstremizmit të dhunshëm.

b

nxit **përgjegjësinë e përbashkët dhe ndarje rolesh** të secilit prej aktorëve të përfshirë në shërbim të mirëqenies së komunitetit.

c

e çon rolin e shkollës përtej “tradicionales” për tu fokusuar në vlerat shoqërore e demokratike, për të siguruar mirëqenien sociale, psikologjike dhe shëndetësore të nxënësve dhe për të fuqizuar familjen.

d

nxit vendim-marrjen e përbashkët, respektimin e diversitetit dhe përdorimin e burimeve të të gjithë anëtarëve të komunitetit në mbështetje të shkollës.

*Një komunitet është i **QËNDRUESHËM** kur zotëron aftësi dhe nxit angazhimin aktiv të aktorëve të ndryshëm vendorë dhe komunitetit duke përdorur gjithë burimet (njerëzore, ligjore dhe financiare) në përgjigje të problematikave dhe fenomeneve të ndryshme, përfshirë dhe atë të ekstremizmit të dhunshëm.*

bashkia

- 1. Kryetari i bashkisë
- 2. Këshilli bashkiak
- 3. Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike
- 4. Shërbime dhe struktura të tjera të bashkisë

grupe komunitare

biznesi

media

persona me influence



SHQK

OSH

komunitete fetare


grupe rinore

shkolla

- 1. Staf i mësimor
- 2. Qeveritë e nxënësve
- 3. Bordet e prindërve
- 4. Shërbimi psiko-social

policia

- 1. Ruajtjen e rendit dhe sigurisë vendore
- 2. Parandalimin e fenomeneve që çenojnë sigurinë dhe mirëqenien e komunitetit



VIZIONI DHE
**PËRGJEGJËSIA E
PERBASHKET**

Megjithë arritjet në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm, punën parandaluese të institucioneve në nivel kombëtar dhe vendor, gjetjet nga studimi i fundit i IDM-së "Ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri", 2015 sugjerojnë se Shqipëria duhet të vazhdojë të punojë në drejtim të parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm (EDH) dhe të ngrejë komunitete të qëndrueshme ndaj ideologjive të EDH. Studimi sugjeron investime të mëtejshme "duke përdorur faktorët e qëndrësës siç janë arsimimi, fuqizimi i grave, informimi dhe vigjilenca e publikut për të luftuar diskriminimin dhe paragjykimet, etj".

Në këtë kontekst, **"Shkolla si qendër komunitare"** përbën një instrument të rëndësishëm në forcimin e komuniteteve vendore. Ky model synon ta kthejë shkollën në vendin ku ndërtohet partneriteti institucionet qeverisëse vendore-shkollë- familje-komunitet, si një mjedis që është në shërbim dhe në bashkëveprim me komunitetin; që kontribuon në zhvillimin e të rinjve dhe angazhimin qytetar; që mbështet familjet dhe zhvillimin e komuniteteve si nga pikëpamja e sigurisë vendore ashtu dhe në atë të angazhimit të tyre në vendimmarrje dhe rritjen e demokracisë vendore. Dimensionin vendor është i një rëndësie të veçantë, nëpërmjet të cilit i kushtohet vëmendje "mjedisit" (nga pikëpamja e zhvillimit ekonomik, shoqëror, ndër-kulturor, sigurisë vendore, demokracisë vendore) si element favorizues ose jo i fenomeneve negative, i kushtohet rëndësi familjeve dhe komunitetit në tërësinë e tij.

Eksperienca e ngritur mbi modelin "shkolla qendër komunitare", integron ndërveprimin e institucioneve kryesore në nivel vendor ndërmjet tyre dhe komuniteteve vendore:


Njësitë e qeverisjes vendore, kryetari i Bashkisë, Këshilli Bashkiak, Këshilli Vendor i Sigurisë Publike gjithmonë e më tepër po angazhohen në fushën e sigurisë dhe të parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm. Eksperienca në bashkitë Cërrik dhe Peqin dëshmon se angazhimi i këtyre institucioneve të qeverisjes vendore në aktivitete në kuadër të planit të punës për "shkollat si qendër komunitare" është një mundësi për sukses në përmirësimin e këtyre shërbimeve ndaj qytetarëve.

Siç dëshmon eksperienca e IDM-së në shkollat "Tomorr Sinani" Cërrik dhe "Zihni Magani" Peqin, policia është përfituese absolute në këtë bashkëpunim. Nëpërmjet pjesëmarrjes në këto aktivitete, policia vendore plotëson objektivat e saj të punës në kuadër të planit vendor të "policimit në komunitet". Aty policia realizon komunikime të përmuajshme me komunitetin e prindërve, nxënësve, të rinjve dhe adreson problematika të ndërsjellta me këta aktorë.

SHEMBUJ
**TË PRAKTIKËS
SË MIRE**

Sigurim i mirëqenies sociale, emocionale dhe shëndetësore të fëmijëve me synim: ofrimin e programeve në bashkëpunim me prindërit dhe partnerë të tjerë të komunitetit për të njohur, adresuar dhe përmbushur nevojat fizike, emocionale dhe sociale të nxënësve dhe për të garantuar zhvillimin e tyre të shëndetshëm.

- Takime të përmuajshme mbi rolin e shërbimeve psiko-sociale tek nxënësit si dhe thyerja e tabu-ve të marrëdhënies nxënës- prind-psikolog.
- Takime informuese të përmuajshme ndërmjet përfaqësuesve të komisariateve të policisë dhe prindërve, nxënësve, pjesëtarëve të tjerë të komunitetit mbi sigurinë e nxënësve në ambientet e shkollës dhe jashtë saj, menaxhimi i situatave problematike dhe nxitja e raportimit në institucionet kompetente, përdorimi i lëndëve narkotike, duhanit, alkoolit, etj.
- Krijimi i klubeve sportive “Basketboll”, “Handboll”, “Volejboll” me përfshirjen edhe të të rinjve dhe anëtarëve të komunitetit.
- Organizim i aktiviteteve artistike dhe kulturore nga klubet e “Kërcimit” dhe “Trashëgimisë”, “Klubet e letërsisë” me nxënës dhe të rinj me qëllim promovimin e vlerave kulturore, tradicionale, fetare, artizanale dhe kulinare të zonave.



Vendim-marrja e përbashkët si dhe zhvillimi i komunitetit - Shkolla ofron shërbime/ programe që shërbejnë për zhvillimin e komunitetit dhe anasjelltas për të nxitur komunitetin të jetë pjesë përbërëse e aktiviteteve që organizon shkolla

- Hartimi, monitorimi dhe rishikimi i planeve vjetore të shkollës me përfshirjen e prindërve, komunitetit dhe institucioneve publike.
- Konsolidim/nxitje e marrëdhënies tre-palëshe komunitet-polici-bashki.
- Ofrim për herë të parë i moduleve të programimit kompjuterik (coding) në shërbim të të rinjve, me qëllim rritjen e kapaciteteve të tyre dhe shtimin e mundësive të punësimit bazuar në kërkesat e tregut të punës.
- Aktivitete manuale si pirografi, qeramikë, plastelinë, pikturë për fëmijët më të vegjël të komunitetit.
- Pasurim i bibliotekës, ngritja e klasave multifunksionale dhe ofrim i kurseve të rrobaqepsisë në dispozicion edhe të komunitetit vendor.



Promovimi i gjithë-përfshirjes dhe ndërgjegjësimit i qytetarëve mbi respektimin e diversitetit

- Takime të përmuajshme diskutimi të udhëhequra nga psikologët e shkollave me stafin mësimor, nxënësit dhe prindërit mbi respektimin e diversitetit, gjithë-përfshirjes dhe shmangies së çdo lloj forme të diskriminimit.
- Aktivitete ndërgjegjësuese nga vetë të rinjtë kundër diskriminimit dhe paragjykimit.
- Aktivitete informuese në bashkëpunim me institucionet ligj-zbatuese dhe komunitetet fetare për fenomene si ekstremizmi i dhunshëm, bullizmit, dhuna në familje.
- Trajnime me prindërit mbi çështje të edukimit, modele të prindërimit, dhuna në familje.



Angazhimi i të rinjve në komunitet

- “Java e lidershipit”, një iniciativë e grupeve rinore me natyrë informative, argëtuese dhe ndërvepruese.
- Nxitja e vullnetarizmit tek të rinjtë dhe ndërmarrja e një sërë aksionesh komunitare.
- “Të rinjtë për komunitetin” - nisma novatore ku të rinjtë ftojnë përfaqësues nga bashkitë dhe komisaritet vendore për të diskutuar mbi shqetësimet e rinisë dhe problematikat që ata hasin në qytetet ku jetojnë.
- Aktivitete që nxisin vetëvlerësimin e të rinjve dhe i përgatisin ata të propozojnë iniciativa, të ndajnë përgjegjësitë dhe t’i realizojnë ato.

